

ERMAL NUFI

Z. Ermal Nufi mban pozicionin e drejtorit të kabinetit të Zëvendëskryeministrit prej gushtit të vitit 2022.

Ai ka përfunduar studimet e nivelit “Master në drejtësi pranë Fakultetit të Drejtësisë, të Universitetit të Tiranës, në vitin 2010.

Pas diplomimit, z. Nufi ka punuar si konsulent ligjor në sektorin privat dhe atë të organizatave jofitimprurëse, vendase dhe ndërkombëtare. Gjithashtu, z. Nufi ka mbajtur edhe pozicionin e pedagogut të jashtëm në të drejtën civile dhe tregtare pranë Institutit të Studimeve Strategjike dhe Trajnimeve.

Që prej vitit 2013, është licencuar si avokat nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë, ku ka shërbyer edhe si anëtar i Këshillit Drejtues të Dhomës së Avokatëve të Tiranës. Nga viti 2021 z. Nufi ka mbajtur pozicionin e këshilltarit ligjor të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe ka shërbyer në pozicione të ndryshme brenda administratës publike shqiptare.

Aktualisht, me vendim të Këshillit të Ministrave, ai është emëruar kryetar i Bordit Menaxhues të Autoritetit Rrugor Shqiptar, anëtar i Këshillit Drejtues të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, si dhe *ex-officio* kryeson Bordin e Agjencisë Shtetërore të Informacionit Gjeohapësinor.

ALKETA PANO

Znj. Alketa Pano mban pozicionin e këshilltares së Zëvendëskryeministrit prej muajit tetor 2024 për çështjet e koordinimit.

Znj. Pano është një profesioniste me përvojë të gjerë në administratën publike dhe sektorin privat. Nga viti 2022 deri në tetor 2024, ajo ka shërbyer si asistente e Zëvendëskryeministrit në Kryeministri, ku ishte përgjegjëse për koordinimin e agjendës së përditshme dhe mbështetjen administrative të zyrës së tij.

Nga nëntori 2017 deri në fund të vitit 2022 ka mbajtur pozicionin e drejtorit të Drejtorisë së Eventeve Qeveritare, Publike dhe Jopublike si dhe të drejtorit të Pallatit të Kongreseve në Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare. Në këtë rol, Znj. Pano ka drejtuar me sukses organizimin dhe menaxhimin e eventeve të nivelit të lartë, duke mbikëqyrur menaxhimin logjistik dhe administrativ për evente të llojit konferenca, samite, ministeriale etj. që kërkojnë përfshirje të gjerë institucionale.

Përveç funksioneve në administratën publike, znj. Alketa Pano ka një përvojë të gjatë në sektorin e shërbimeve dhe projekteve të zhvillimit kombëtar dhe ndërkombëtar. Ajo ka shërbyer për 10 vite si menaxhere e zyrës në Institutin e Studimeve Bashkëkohore (ISB), dhe si menaxhere zyre dhe logjistike në Qendrën Shqiptare për Tregtinë Ndërkombëtare, e mbështetur nga USAID-i.

Znj. Pano ka përfunduar studimet e larta në degën “Kimi industriale” në Fakultetin e Shkencave të Natyrës në vitin 1991, degë që i ka dhënë një qasje analitike dhe të strukturuar në zgjidhjen e sfidave profesionale.

SEJDIN METANI

Z. Sejdin Metani mban pozicionin e këshilltarit të Zëvendëskryeministrit prej muajit shtator 2024 për çështjet e protokollit.

Z. Metani ka përfunduar studimet ne “Universitetin e Sporteve” në nivelin “Master profesional”. Gjithashtu, vazhdon edhe studimet e nivelit “Master shkencor” për marketing dhe marrëdhënie me publikun.

Z. Metani vjen nga një eksperiencë e gjatë në sektorin e turizmit dhe sportit. Ai ka një eksperiencë prej afro 7 vitesh në fushën e aviacionit ku ka punuar në përpunimin e manualeve të reja, hartimin e procedurave, rekrutimin dhe trajnimin e stafit dhe organizimin e gjithanshëm të kompanive ajrore.

ARLINDA TOPÇIU

Znj. Arlinda Topçiu mban detyrën e drejtorit të kabinetit pranë ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët që nga tetori i vitit 2021. Ajo vjen nga një eksperiencë disavjeçare në fushën e konsulencës financiare dhe botës akademike. Më parë znj. Topçiu ka qenë lektore në departamentet e Kontabilitetit dhe Financës, me kohë të plotë, pranë Universitetit Amerikan të Lindjes së Mesme, në Kuvajt, për një periudhë 5-vjeçare. Karriera e saj ka filluar në kompanitë e konsulencës financiare BIG-4 në Shqipëri, konkretisht KPMG Albania dhe *PricewaterhouseCoopers Audit*, sh.p.k.

Znj. Topçiu ka përfunduar studimet “Bachelor” për financë dhe kontabilitet, në Fakultetin e Ekonomisë, të Universitetit të Tiranës, si dhe “Master i shkencave” në “Kontabilitet dhe auditim”, në Fakultetin e Ekonomisë, të Universitetit të Tiranës, dhe Fakultetin e Ekonomisë dhe Menaxhimit, në Universitetin e Letonisë, Letoni, me rezultate të shkëlqyera. Gjithashtu, ka ndjekur një sërë studimesh pasuniversitare si në Maastricht School of Management dhe aktualisht po ndjek studimet e ciklit të tretë, Doktoraturë, pranë Fakultetit të Ekonomisë, të Universitetit të Tiranës.

Paralelisht, Znj. Topçiu mban postin e pedagogut të jashtëm pranë Universitetit Luarasi, Tiranë.

ALKETA DOÇI

Znj. Alketa Doçi mban detyrën e këshilltares në kabinetin e ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, që nga shkurti i vitit 2022.

Znj. Alketa Doçi e filloi karrierën e saj si volejboliste në ekipin e “Dinamos” dhe Ekipin Kombëtar Shqiptar. Me një karrierë të gjatë dhe të shkëlqyer jashtë vendit, në ekipet elitare të Francës dhe Greqisë, ka triumfuar disa herë si “Lojtarja më e Mirë” e Ballkanit, Greqisë e Francës. Ajo është shpallur dy herë “Kampionë Ballkani në Volejball”, dy herë “Nënkampionë Ballkani në Volejball”, kampionë në “*European Champions Ligue*” për volejball, si dhe është kualifikuar tre herë në finalen e “*European Champions Ligue*”. Me pas ajo vijoi punën si trajnere me ekipet e moshave të ndryshme në Francë.

Për meritat e saj është nderuar dhe vlerësuar nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë me titullin “Mjeshtër i Merituar i Sportit”.

Znj. Doçi ka një sërë kualifikimesh dhe titujsh profesionalë, “Negociator tekniko-komercial”, të akorduar nga Ministria e Punës, Francë, certifikatë e kualifikimit profesional “Për menaxhimin dhe emigrimin” nga autoritetet e Italisë, etj.

SARA KAPOLI

Znj. Sara Kapoli mban aktualisht pozicionin e këshilltares në kabinetin e ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, që prej muajit gusht të vitit 2024.

Znj. Kapoli ka një eksperiencë disavjeçare në sektorin privat dhe publik. Karriera e saj në administratën publike ka nisur si juriste në sektorin juridik pranë Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), ku ka luajtur një rol kyç në ofrimin e asistencës ligjore dhe mbështetjes për procedurat administrative dhe ligjore. Më pas, ajo ka mbajtur detyrën e përgjegjëses në sektorin e prokurimeve pranë së njëjtës agjenci. Kjo përvojë i ka mundësuar znj. Kapoli të zhvillojë një njohuri të thellë të administratës publike dhe të prokurimeve, duke kontribuar në rritjen e efikasitetit e të transparencës në shërbimet publike.

Znj. Kapoli është diplomuar për drejtësi në Fakultetin e Drejtësisë, të Universitetit të Tiranës, dhe ka përfunduar studimet e nivelit “Master i shkencave” në të drejtën publike. Gjithashtu, ka kryer një sërë trajnimesh në fushën e prokurimeve publike, konfliktit të interesit, menaxhimit të performancës, të drejtës së informimit dhe mbrojtjes së të dhënave personale etj.

JUNIDA BAZE

Znj. Junida Baze mban detyrën e këshilltares në kabinetin e ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, që prej muajit mars të vitit 2022. Znj. Baze ka një eksperiencë disavjeçare në sektorin privat, ku karriera e saj ka filluar si financiere. Ajo është promovuar më pas në pozitë të menaxhimit të stafit të kompanisë për një periudhë njëvjeçare, para se të kalonte në kabinetin e ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët.

Në këtë rol, ajo ka kontribuar në zhvillimin dhe implementimin e programeve të ndryshme për rininë dhe fëmijët. Përgjegjësitë e saj përfshijnë menaxhimin dhe organizimin e trajnimeve dhe aktiviteteve për rininë, si dhe koordinimin e punës me donatorët për sigurimin e mbështetjes financiare dhe teknike. Znj. Baze ka marrë pjesë aktive në grupe të punës ndërinstitucionale dhe ka kontribuar në projekte të ndryshme në bashkëpunim me organizata ndërkombëtare.

Znj. Baze ka studiuar për financë në Fakultetin e Ekonomisë, të Universitetit të Tiranës, dhe aktualisht po ndjek studimet për “Bachelor në psikologji” në *Ecampus University*. Ajo ka përfunduar gjithashtu studimet njëvjeçare në Akademinë e Studimeve Politike, duke përforcuar njohuritë e saj në dinamikën politike. Gjithashtu, ka kryer disa trajnime të specializuara në Londër, të cilat i kanë dhënë asaj certifikata në menaxhimin e performancës, për të krijuar një profil profesional të plotë.

MARTIN KAJO

Z. Martin Kajo mban pozicionin e drejtorit të kabinetit të ministrit të Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit që prej tetorit 2023. Në periudhën 2022-2023 ka mbajtur pozicionin e drejtorit të kabinetit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe ka punuar si këshilltar në këtë ministri për periudhën maj–gusht 2022. Përpara angazhimeve të tij në administratën publike shqiptare, z. Kajo ka punuar si menaxher operativ në Milano, Itali, për një zinxhir kompanish në sektorin e shërbimeve (2017–2022), si dhe ka shërbyer si menaxher rajonal për të njëjtën kompani (2014–2017).

Z. Kajo ka përfunduar studimet e larta pranë “*Università degli Studi di Milano*” në Itali, ku ka marrë diplomën “Bachelor” dhe “Master” në drejtësi, me specializim në të drejtën civile. Në vitin 2017, ai përfundoi me sukses provimin e avokatisë dhe u anëtarësua në Dhomën e Avokatisë të Republikës së Shqipërisë.

FJORIND LIKA

Z. Fjorind Lika mban pozicionin e këshilltarit në kabinetin e ministrit të Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit nga muaji nëntor i vitit 2024. Më herët ka mbajtur pozicionin e këshilltarit në kabinetin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë nga muaji tetor i vitit 2019 deri në muajin nëntor të vitit 2024, si dhe përkohësisht ka ushtruar funksione drejtuese edhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Administrimit të Pronës Publike pranë kësaj ministrie. Përgjatë kësaj periudhe, kryesisht fushat e angazhimit të mbuluara kanë përfshirë çështjet e legjislacionit, të gjyqësorit, të bashkëpunimit tregtar, të integritimit evropian dhe të marrëdhënieve me Kuvendin. Në periudhën 2012-2019 ka ushtruar funksione hierarkike në Drejtorinë e Përgjithshme të Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor. Përgjatë karrierës së tij, ka ushtruar funksione përfaqësimi në organe të ndryshme të administrimit, mbikëqyrjes dhe këshillave drejtues në disa institucione publike dhe të pavarura. Z. Lika është diplomuar në Fakultetin e Drejtësisë, të Universitetit “Luarasi”, ku ka kryer studime të nivelit “Master i shkencave”. Z. Lika zotëron titullin “Avokat”, të lëshuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe njohës i gjuhës angleze dhe italiane. Fushat e angazhimit: Çështjet e legjislacionit, të sipërmarrjes private, të klimës së biznesit, të lehtësimit të procedurave të shërbimeve publike ndaj sipërmarrjes, të zhvillimit të politikave ekonomike, të mbështetjes të *startup-eve*, të dialogimit me biznesin dhe dhomat e tregtisë, të inspektimit të përgjithshëm, të drejtës së informimit dhe konsultimit publik, si dhe të marrëdhënieve me Kuvendin.

ODETA BERBERI

Znj. Odetta Berberi shërben si drejtore e kabinetit të ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin prej gushtit 2024.

Nga shtatori 2023 deri në gusht 2024 znj. Odeta Berberi ka qenë e angazhuar si këshilltare diplomatike e ministrit të Brendshëm dhe nga viti 2019 deri në shtator të 2023 ka punuar për Kuvendin e Shqipërisë në pozicionin e Këshilltares Diplomatike të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, duke asistuar me ekspertizë në fushat e portofolit që mbulojnë integrimin evropian, marrëdhëniet rajonale dhe reformën zgjedhore. Përpara vitit 2019, znj. Berberi ka punuar konsulente në disa projekte evropiane dhe asistente e lartë në misionin e OSBE/ODIHR për zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2017.

Znj. Odeta Berberi ka përfunduar doktoraturën në Fakultetin e Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës. Në shtator të vitit 2022 ishte fituese e një programi kërkimor në *Cranfield University* (Britani e Madhe) mbi diplomacinë kibernetike. Znj. Berberi është diplomuar në “Marrëdhënie ndërkombëtare” në vitin 2007, në “Università degli Studi di Perugia” (Itali) dhe ka përfunduar me sukses tri programe të nivelit master: “Master në etikën e biznesit” (2008) në Universitetin e Sienës (Itali); “Master në marrëdhënie ndërkombëtare” (2010) nga *Università degli Studi di Perugia* (Itali); “Master rajonal evropian në demokraci dhe të drejtat e njeriut në Evropën Juglindore” (2011) nga Universiteti i Bolognës.

Znj. Berberi ka një përvojë kërkimore dhe mësimdhënieje për më shumë se një dekadë. Dhe është pedagoge e jashtme prej vitit 2011 në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale, si dhe në disa universitete private në Shqipëri. Ajo ka kryer kërkimin e doktoraturës në Universitetin e Bolonjës (2015-2016) si pjesë e programit të përbashkët të shkëmbimit të doktoraturës BE-EJL. Znj. Berberi është autore e disa artikujve shkencorë, e një libri dhe prezantimeve në aktivitete shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.

FOTJONA TAÇE

Znj. Fotjona Taçe mban pozicionin e drejtorit të kabinetit të ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin që prej muajit shkurt të vitit 2024. Znj. Fotjona Taçe ka mbi 17 vjet karrierë profesionale në konsulencë dhe menaxhimin e programeve zhvillimore ndërkombëtare.

Ajo zotëron ekspertizë të thellë në menaxhimin strategjik të projekteve komplekse me ndikim të qëndrueshëm në sektorët kyç të ekonomisë së vendit. Më parë, znj. Taçe ka udhëhequr programe të partnerëve dhe donatorëve kryesorë ndërkombëtarë në Shqipëri dhe vendet e Ballkanit Perëndimor në sektorë, si bujqësia, turizmi, fintech & inovacioni dhe trashëgimia kulturore.

Znj. Taçe, gjithashtu, ka drejtuar në portofolin e saj projekte me fokus në zhvillimin e NVM-ve, përmes inovacionit dhe aksesit në financë. Më herët ajo ka shërbyer në role të ndryshme në industrinë e telekomunikacionit. Znj. Taçe gëzon reputacion të lartë për aftësitë e saj drejtuese në mjedise dinamike, me ritme të shpejta duke u fokusuar në

gjenerimin e rezultateve. Ajo ka zhvilluar studimet e larta pranë Universitetit të Tiranës, në administrim publik, si dhe studime të niveli “Master profesional” për menaxhim biznesi.

SILVANA RUSI

Znj Silvana Rusi shërben si këshilltare e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, e angazhuar në çështje të mirëqeverisjes dhe proceseve integruese të BE-së. Në këtë rol ajo mbështet përpjekjet e qeverisë shqiptare për zbatimin e Reformës në Administratën Publike dhe garantimin e parimeve të mirëqeverisjes, në përputhje me agjendën e integritimit evropian të Shqipërisë.

Më parë, znj. Rusi ka shërbyer si asistente e zëvendësministrit të Drejtësisë, njëherësh negociator për kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, duke kontribuar në portofolin e luftës kundër korrupsionit dhe kuadrit strategjik të reformës në drejtësi. Paralelisht, ka qenë e angazhuar pranë Avokaturës së Shtetit, në Zyrën e Përfaqësimit në Gjykatat e Huaja dhe Ndërkombëtare dhe Arbitrazhin Ndërkombëtar, ku ka asistuar në përfaqësimin e shtetit shqiptar në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në një numër çështjesh lidhur me zbatimin e reformës në drejtësi, të drejtat pronësore dhe mosdiskriminimin. Më parë, znj. Rusi ka mbajtur rolin e ekspertit për integrimin evropian për kapitullin 23 pranë projektit SEI (Mbështetje për integrimin evropian të Shqipërisë). Znj. Rusi është diplomuar në Universitetin e Tiranës ku ka kryer studime të nivelit “Master i Arteve” në studime ndërdisiplinore evropiane nga Kolegji i Evropës, Belgjikë.

Aktualisht është kandidat në studimet e nivelit “Master (LL.M.) në të drejtën evropiane” pranë Universitetit të *Lorraine*, Francë.

LOREN KOÇOLLARI

Z. Loren Koçollari shërben në rolin e këshilltarit të komunikimit të ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, ku ofron ekspertizë të kualifikuar dhe koordinim në çështje të komunikimit publik të ministrit të Shtetit, komunikimit ndërinstytucional dhe marrëdhënieve me publikun. Më parë, ka punuar si këshilltar komunikimi i Presidentit të Republikës, ku përfundoi në mënyrë të suksesshme programin “*Lead Albania*”.

Z. Koçollari gëzon një eksperiencë të larmishme nëpërmjet përvojave profesionale përfshirë si konsulent komunikimi i OKB-së, gazetar në media të ndryshme audiovizive, si dhe kërkues në organizata të ndryshme. Ai ka ndjekur studimet “Bachelor” për gazetari në Universitetin e Tiranës, për të vazhduar më pas me studimet e nivelit “Master” në Universitetin e Bolonjës dhe Universitetin e Strasburgut për kulturë letrare evropiane (CLE).

Gjithashtu, është diplomuar për studime të thelluara Evropiane në Kolegjin Evropian të Parmës. Aktualisht, është kandidat PhD, duke ndjekur studimet doktorale në Budapest, Universitetin Korvinus për shkenca politike, me fokus komunikimin politik.

SILVANA RAMADANI

Znj. Silvana Ramadani është audituese ligjore me përvojë profesionale 12-vjeçare në sektorin publik, me njohuri të thella në fushën e auditimit të jashtëm publik. Aktualisht, ajo shërben në rolin e këshilltares për çështjet antikorupsion pranë ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorupsionin, ku nëpërmjet angazhimit të saj kontribuon në avancimin e politikave dhe përmbushjen e agjendës së shtetit shqiptar në luftën kundër korrupsionit.

Më parë znj. Ramadani ka shërbyer për 7 vjet si audituese e lartë në Kontrollin e Lartë të Shtetit, ku ka dhënë ekspertizën e saj në përmirësimin e menaxhimit të financave publike dhe rritjen e efektivitetit të institucioneve të administratës publike. Përpos angazhimit të saj në administratën publike, znj. Ramadani ka shërbyer për 4 vite si pedagoge me kohë të pjesshme në Fakultetin e Drejtësisë, të Universitetit “Luarasi”, gjatë viteve akademike 2018-2022, në lëndën “E drejta e detyrimeve dhe kontratave”. Ajo është e diplomuar në Drejtësi, dhe zotëron një “MSc në të drejtën civile dhe tregtare” dhe ka fituar titullin “Avokat” në vitin 2015.

LORINA MISKU

Znj. Lorina Misku mban pozicionin e këshilltarit të parë të ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator. Znj. Misku ka kryer studimet për drejtësi, në Universitetin e Tiranës, si dhe studime të nivelit “Master i shkencave” në të drejtë publike. Fokusi profesional është integrimi evropian, e drejta publike dhe politikat zhvillimore, si dhe qasja menaxheriale. Më herët në vite ka shërbyer si specialist në Departamentin e Zhvillimit dhe Planifikimit Strategjik në Kryeministri, më tej si koordinatorë e Politikave dhe Prioriteteve Kombëtare, në Kryeministri, si dhe ka asistuar si asistent pedagog, në Universitetin e Tiranës në Fakultetin e Drejtësisë. Znj. Misku gjithashtu ka eksperiencë edhe me shoqërinë civile ku ka punuar nëpërmjet praktikës, si ndihmës hulumtues në Lëvizjen Evropiane në Shqipëri. Aktualisht, asiston në Universitetin Metropolitan, si pedagog i ftuar. Znj. Misku ka kryer një sërë trajnimesh për fushat e saj të interesit, proceset e integritetit në veçanti në Alumni i European University Institute (EUI), me bazë Firence në Itali, Akademisë Diplomatike të Vjenës, me bazë në Vjenë, Austri, rrjetit të Shkollave Politike të Këshillit të Evropës, e Akademisë së Integritetit Evropian dhe Negociatave, si dhe është bashkautore e 3 publikimeve, pranë Universitetit të Tiranës.

UJVARA PONARI

Znj Ujvara Ponari me një përvojë të fortë në këshillim politik dhe menaxhim projektsh, aktualisht shërben si koordinator në zyrën e menaxhimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm së Kryeministrit, ku drejton proceset administrative dhe përmirëson koordinimin ndërdepartamental si dhe institucional.

Më herët ka mbajtur postin si ndihmëskëshilltar diplomatik i Presidentit të Shqipërisë, duke dhënë kontribute të rëndësishme në formësimin e politikës së brendshme dhe të jashtme. Në bashkëpunim me Albanian Policy Center, ka bashkëshkruar projektpropozime të suksesshme mbi demokracinë dhe lidhshimin, veçanërisht në dobi të të rinjve dhe grave. Përgjatë një viti në programin “*LEAD Albania*”, në rolin e këshilltares për të drejtat e njeriut dhe rininë në Ministrinë e Punëve të Jashtme, ka drejtuar seminare dhe konferenca, duke përfshirë një bashkëpunim të dukshëm me Këshillin e Evropës dhe OSBE-në mbi “Lirinë e shprehjes”.

Gjithashtu, si Sekretar i Parë në Misionin e Përhershëm të Shqipërisë pranë Organizatave Ndërkombëtare në Vjenë, ka prodhuar raporte kritike mbi aktivitetet e OSBE-së, duke kontribuar në strategjinë diplomatike të Shqipërisë.

Karriera e hershme përfshin role si asistent i menaxherit të projektit në Iniciativën e Bashkëpunimit të Evropës Juglindore SECI, të cilat forcojnë interesin dhe ekspertizën në fushën ndërkombëtare dhe rajonale.

Mban titullin “Master i arteve në të drejtat e njeriut” nga Universiteti i Vjenës, si dhe ka kryer studime të nivelit “Master në të drejtën e biznesit të BE-së” në Universitetin e Tiranës dhe të nivelit “Bachelor i arteve në biznes dhe marrëdhënie ndërkombëtare” në Universitetin e Anglisë Perëndimore, UËE Bristol.

Znj. Ponari ka kryer gjithashtu kurse dhe certifikime të shumta të specializuara, duke përfshirë Programin Global të Udhëheqjes G20, seminarin e lidhshimit në Aspen, zhvillimin e politikave për t’iu kundërvënë ekstremizmit fetar nëpërmjet edukimit nga Fondacionin Tony Blair, IACA shkollë verore për antikorrupsion dhe kurse mbi politikën e sigurisë në Qendrën e Gjenevës për Politikën e Sigurisë, si dhe kurset bazë të Akademisë Diplomatike të Vjenës mbi të drejtën ndërkombëtare dhe diplomacinë shumëpalëshe.

HERALD JONUZAJ

Z. Herald Jonuzaj mban pozicionin e drejtorit të Departamentit të Akteve Rregullatore të Këshillit të Ministrave nga marsi i vitit 2023. Ai organizon punën dhe drejton departamentin për realizimin e synimit kryesor për dhënien e asistencës juridike për projektaktet që vijnë për shqyrtim dhe miratim, me qëllim garantimin e ligjshmërisë dhe uniformitetit vendimmarrës të Këshillit të Ministrave.

Z. Jonuzaj ka një eksperiencë të gjatë në disa pozicione të rëndësishme në administratën shtetërore. Nga korriku 2019 deri në mars 2023 ka drejtuar Njësinë e Akteve Rregullatore të Këshillit të Ministrave, në Kryeministri. Nga shkurti deri në tetor 2018 ka mbajtur pozicionin e koordinatorit në zyrën e menaxhimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave.

Z. Jonuzaj në gusht 2015 deri në dhjetor 2017 ka qenë pjesë e Avokaturës së Shtetit si avokat shteti, në Zyrën e Këshillimit dhe Koordinimit Ndërministror. Në mars 2011 deri në korrik 2017 ka qenë pjesë e Ministrisë së Mbrojtjes, ku ka ushtruar detyrën e juristit në sektorin e marrëveshjeve ndërkombëtare, në Drejtorinë Juridike si dhe në sektorin e mbështetjes ligjore, në Drejtorinë e Legjislacionit. Në dhjetor 2010 deri në mars 2011 ka shërbyer në Akademinë Ushtarake “Skënderbej”.

Z. Jonuzaj ka mbaruar studimet e larta në Itali, në shkenca juridike. Në periudhën 2008 – 2010 ka ndjekur studimet të nivelit “Master në shkenca juridike” në Universitetin Roma “Tor Vergata”. Në vitet 2005 – 2008 ka ndjekur studimet në Universitetin e Modenas dhe Reggio Emilia, në shkenca juridike. Në periudhën 2007 – 2010 ka ndjekur Shkollën e Oficerëve dhe Karabinierëve në Romë dhe ka marrë gradën “Toger”. Në vitet 2005 – 2007 ka ndjekur Akademinë Ushtarake të Modenas dhe ka marrë gradën “Nëntoger”.

Gjithashtu, z. Jonuzaj është njohës shumë i mirë i gjuhës italiane dhe angleze.

DRITAN PALNIKAJ

Z. Dritan Palnikaj, aktualisht mban pozicionin e drejtorit të Departamentit të Miradministrimit në Kryeministri.

Përpara këtij pozicioni, ai ka shërbyer si këshilltar në kabinetin e Kryeministrit si dhe Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Brendshme në periudhën 2018-2019. Z. Palnikaj ka një përvojë të pasur në administratën publike, duke punuar gjithashtu si ndihmës, analist dhe këshilltar në kabinetin e Kryeministrit për një periudhë 5-vjeçare, ku ka kontribuar në hartimin e politikave dhe strategjive të qeverisë.

Karriera e z. Palnikaj ka filluar si inspektor jurist pranë Agjencisë së Kthimit të Pronave si përfaqësues i institucioneve në gjykata, si dhe avokat, duke thelluar njohuritë dhe eksperiencën e tij në çështjet e pronësisë dhe ato civile.

Z. Palnikaj është diplomuar në vitin 2009 në Fakultetin e Drejtësisë, në Universitetin e Tiranës, dhe po në këtë universitet ka përfunduar studimet e nivelit “Master i shkencave në legjislacion dhe institucione evropiane” pranë ISE-së. Z. Palnikaj ka marrë pjesë në disa konferenca shkencore dhe ka botuar punime kërkimore, të cilat pasqyrojnë njohuritë e tij në fushën e ligjit dhe administratës publike. Prej vitit 2018 mban gradën shkencore “Doktor”.

Z. Palnikaj ka pasur mundësinë të zhvillojë aftësitë e tij profesionale përmes trajnimeve dhe kurseve të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Ai ka përfunduar kursin e lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes në vitin 2019, ku ka marrë pjesë në vizita në zyrat qendrore të NATO-s në Belgjikë dhe Itali. Po ashtu, ai ka ndjekur trajnime të rëndësishme, si në *Harvard Kennedy School of Laë*, në SHBA, “*Emerging leaders program*” dhe ka kryer një trajnim në *Center for Creative Leadership* në Bruksel, Belgjikë.

ADRIAN KAMENICA

Z. Adrian Kameniva mban funksionin e drejtorit të Departamentit të Politikës dhe Integritit Evropian, Kryeministri.

Z. Adrian Kamenica ka mbi 27 vjet përvojë pune kryesisht në sektorin privat, që përfshin rreth një dekadë në Greqi, ku ka shërbyer së fundi si drejtues i departamentit të blerjeve ndërkombëtare për një kompani multinacionale në fushën e inxhinierisë mekanike, duke vazhduar më pas si drejtues rajonal i së njëjtës kompani në Shqipëri. Në vijim është transferuar si drejtues rajonal për Ballkanin dhe Evropën Juglindore i një kompanie Spanjolle në fushën e naftës dhe karburanteve të ngurta.

Në mars 2014 u emërua koordinator i Njesisë për Mbështetjen e Investimeve Strategjike në Kryeministri dhe në janar 2016 është promovuar si drejtor i përgjithshëm i së njëjtës njësi. Në mars 2018 është emëruar Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, dhe në tetor 2021 është emëruar Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Mbrojtjes. Nga dhjetori 2022 mban pozicionin e drejtorit të Përgjithshëm të Departamentit të Politikave dhe Integritit Evropian në Kryeministri, i cili funksionon edhe si Sekretariati i BE-së për procesin e integritit evropian.

Z. Kamendica është diplomuar për menaxhim dhe administrim biznesi nga *Henley Management College* (MB) si dhe mban një “Master të arteve në udhëheqjen e inovacionit dhe ndryshimit në korporata” nga Universiteti York St John (MB), përfshirë edhe një numër trajnimesh dhe kualifikimesh të lidhura me zhvillimin ekonomik nga Qendra për Zhvillimin Ndërkombëtar e Universitetit të Harvardit, administratën publike nga Programi i Bashkëpunimit të Singaporit, si dhe mbi reformat strukturore nga Insituti Joint i Vienës.

ELONA AJAZI

Znj. Elona Ajazi që nga viti 2022 mban pozicionin drejtorit të Njesisë së Integritit Evropian, në Kryeministri. Znj. Ajazi është përgjegjëse për drejtimin, koordinimin dhe mbikëqyrjen e procesit të negociatave dhe anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Znj. Ajazi është eksperte e lartë në financat publike dhe politikat publike zhvillimore. Ajo zotëron diplomë “Master në financë” dhe është kontabiliste e certifikuar, me mbi 18 vjet përvojë në administratën publike shqiptare.

Përvoja e saj si eksperte e politikave publike vjen falë angazhimit të saj në pozicione të ndryshme në Ministrinë e Financave, në fushat e menaxhimit financiar, menaxhimit të borxhit dhe menaxhimit të investimeve publike gjatë periudhës 2007 – 2016. Që nga viti 2016, znj. Ajazi është pjesë e Kryeministrit, duke drejtuar procese kyçe si planifikimi strategjik, koordinimi i politikave prioritare të qeverisë, menaxhimi i projekteve strategjike, si dhe koordinimi i procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Gjatë punës së saj në Kryeministri, znj. Ajazi ka kryer edhe funksionin e sekretariatit teknik të Komitetit të Planifikimit Strategjik, Komitetit Kombëtar të Investimeve, si dhe Sekretariatit të Integritit Evropian.

Gjatë punës së saj në administratën publike ka bashkëpunuar ngushtësisht me institucione dhe partnerë të rëndësishëm ndërkombëtare si: Komisioni Evropian, Banka Botërore, EIB, EBRD, KfE, GIZ, FMN etj.

ORIANA ARAPI

Znj. Oriana Arapi shërben si drejtore e Njesisë së Politikës dhe Agjendës së Reformave drejt BE, në Departamentin e Politikës dhe Integritit Evropian. Ajo ka një përvojë 18-vjeçare profesionale në administratën publike, si zyrtar i mesëm dhe i lartë publik, duke shërbyer fillimisht si koordinatorë e më pas edhe si drejtuese për Njësinë e Koordinimit të Strategjive, Njësinë e Planifikimit Strategjik dhe Programeve të Zhvillimit, Njësinë e Mirëqeverisjes dhe Zhvillimit, në Kryeministri. Fusha e saj e ekspertizës përfshin politikat e administratës publike, politikat e zhvillimit rajonal; planifikim strategjik; planifikim politikash të integritit evropian; hartim e monitorim politikash dhe strategjish; analizë politikash e buxheti; planifikim projekti dhe programi; programim IPA; monitorim dhe vlerësim performance, vlerësim ndikimi të politikës etj.

Gjatë kësaj periudhe znj Arapi ka qenë pjesë e ekipit për procesin e shqyrtimit analitik (screening) për negociatat me BE-në dhe ka drejtuar punën teknike për përgatitjen e strategjive kombëtare për zhvillim dhe integrim; përgatitjen e Agjendës Kombëtare të Reformave; koordinimin dhe monitorimin e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit (MDG), Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG); ngritjen e sistemit të planifikimit IPSIS (*Integrated Planning System Information System*); koordinimin për Listën Unike Kombëtare të Projekteve; përgatitjen e dokumenteve të politikave në nivel qendror; monitorimin në nivel kombëtar të strategjive, koordinim programesh/projektësh me donatorët etj. Përpara angazhimit në administratën publike, znj. Arapi ka një përvojë të mëparshme profesionale, si pjesë e shoqërisë civile dhe e organizatave ndërkombëtare, lidhur me planifikimin dhe menaxhimin e programit/projekteve të financuara nga donatorët.

Gjatë gjithë kësaj kohe, znj. Arapi ka kryer trajnime dhe kualifikime profesionale, si edhe ka marrë pjesë në një serë seminaresh dhe konferencash. Ajo ka ofruar mbështetje të vazhdueshme me trajnime për stafet e ministrive të linjës, agjencive të zbatimit, institucioneve të pushtetit qendror dhe vendor, për fusha dhe procese të ndryshme të ekspertizës. Ajo gjithashtu ka dhënë trajnime për një periudhë 5-vjeçare në Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA). Znj. Arapi ka kryer studime të nivelit “Master i shkencave” në studime evropiane në Universitetin e Danubit në Krems, Austri, dhe ka kryer studimet e larta për gjermanistikë në Universitetin e Tiranës.

EVIS QAJA

Znj. Evis Qaja mban pozicionin e drejtorit të Drejtorisë të Koordinimit Ndërinstitucional dhe Kapaciteteve në Njësinë e Integritit Evropian, Departamenti i Politikës dhe Integritit Evropian në Kryeministri.

Znj. Evis Qaja është diplomuar në Fakultetin e Drejtësisë, të Universitetit të Tiranës, si dhe ka diplomën “Master në integrimin evropian dhe përafrimin e legjislacionit”. Znj. Qaja ka kryer dhe disa studime pasuniversitare dhe trajnime, brenda dhe jashtë vendit, në të drejtë publike të Bashkimit Evropian, ku zotëron “Diplomë e integruar për të drejtën dhe ekonominë evropiane” nga Universiteti e Fakulteti i Drejtësisë, *Riga Graduate School of Law*, “Diplomë në Universitetin Publik”, Greqi, Thessaloniki (*University of Aristotelis*); “Diplomë në marrëdhënie ndërkombëtare dhe diplomaci”, nga Akademia e Diplomacisë Ndërkombëtare të Ministrisë së Jashtme të Gjermanisë (*the Federal Foreign Office of the Federal Republic of Germany*), si dhe është pjesë e rrjetit të diplomatëve ‘*Diplomacy by Networking*’.

Znj. Qaja, për më shumë se një dekadë ka kryer disa funksione drejtuese si nëpunëse civile në drejtori dhe departamente si të planifikimit strategjik, bashkëpunimin për zhvillim dhe ndihmën e huaj; programimin e zhvillimit – planifikimin strategjik; mirëqeverisjen dhe politikën publike, në Kryeministri. Gjithashtu, ka luajtur rolin si pika fokale për ‘*Partneritetin për qeverisjen e hapur*’/Open Government Partnership” të Këshillit të Ministrave si dhe person i certifikuar në ‘*Menaxhimin e cilësisë për administratën publike*’ nga Qendra Kërkimore Publike në Vjenë, (*KDZ Centre for Public Administration Research, Vienna, Austria*).

Me një eksperiencë profesionale në administratën publike dhe me përvojë në drejtim të politikëbërjes/ligjëbërjes, planifikimit strategjik, zhvillimit të politikave/masave legjislative, CAF standarts, analizave funksionale dhe institucionale, matje performance, bashkërendim të proceseve të integritit në BE, koordinim të sistemit të planifikimit të integruar, menaxhim të sektorit të mirëqeverisjes dhe fushave të reformave të administratës publike, shërbimeve, financave publike, antikorrupsion, decentralizim, digjitalizimit, etj. Përmes koordinimit strategjik sektorial dhe ndërsektorial ka mundur hartimin e programeve, sistemeve të performancës si dhe bashkërendimin e politikave efikente në kuadër të procesit të integritit evropian në administratën publike.

Znj. Qaja ka kontribuar edhe në fushën akademike, si lektore në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës si dhe është hartuese e kurrikulave të trajnimit për Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) lidhur me ‘Qeverisjen për integrimin evropian dhe anëtarësimin në Bashkimin Evropian’, ‘Planifikimi Strategjik dhe mekanizmat shtetërorë të politikëbërjes’ etj. Është njohëse e disa gjuhëve të huaja.

ERISELDA ÇOBO

Znj. Eriselda Çobo mban postin e drejtorit të Drejtorisë së Anëtarësimit në BE, prej muajit tetor 2024. Znj. Çobo është pjesë e Kryeministrisë nga viti 2016 në pozicionin e koordinatorit, duke drejtuar ndër vite çështje të tilla si: Reforma e zhvillimit rajonal në Shqipëri, projektet strategjike, politikat publike horizontale, me synim arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, bazuar në metodologjinë, instrumentet dhe procedurat e politikës së anëtarësimit në BE. Ajo ka gjithashtu një eksperiencë të konsoliduar edhe në pushtetin vendor, duke shërbyer si zëvendëskryetare e Bashkisë së

Fierit gjatë viteve 2005 – 2010, ku ka drejtuar sektorët e investimeve publike, shërbimeve dhe urbanistikës.

Znj. Çobo ka qënë e angazhuar gjatë viteve 2010 – 2015, si eksperte e çështjeve të planifikimit dhe zhvillimit të territorit, duke asistuar teknikisht në politikëbërje institucione qendrore si Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit në përgatitjen e bazës ligjore të planifikimit dhe zhvillimit të territorit në Shqipëri, si dhe ato vendore si Bashkia e Tiranës, Korçës, Shkodrës, Fierit, Librazhdit, Përrenjasit, Cërrikut, në përgatitjen e planeve të përgjithshme vendore. Ajo ka bashkëpunuar me studio prestigjioze ndërkombëtare në punën e saj si eksperte, ku vlen të përmenden: *Stefano Boeri Architetti*, UNLab, BOLLES+ËILSON, COOPROGETTI S.c.r.l.

Znj. Çobo ka një eksperiencë shumëvjeçare në mësimdhënie, ku prej vitit 2017 ajo mban pozicionin e lektorit me kohë të pjesshme në lëndët e legjislacionit të planifikimit të territorit dhe rigjenerimit urban, pranë Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës.

Znj. Çobo është diplomuar në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, dega arkitekturë, si dhe në Universitetin Politeknik të Milanos (Itali) me “Master i shkencave për planifikimin e territorit”. Gjithashtu, ka kryer një sërë trajnimesh dhe kualifikimesh në çështje të integritimit evropian, procesin e negociatave të anëtarësimit, politikave mjedisore, në fushën e lidërshpimit, menaxhimit të projekteve, politikave publike, zhvillimit të qëndrueshëm etj.

ITENA ÇUÇI

Znj. Itena Çuçi, aktualisht mban pozicionin e koordinatorit të grupimit të I-rë të kapitujve “Themelorët”, në Drejtorinë për Anëtarësimin në BE, në Njësinë e Integritimit Evropian, Departamenti i Politikës dhe Integritimit Evropian në Kryeministri. Rrugëtimin në fushën e integritimit evropian e nisi që prej vitit 2016 në Ministrinë e Integritimit Evropian si specialiste në Drejtorinë e Përafrimit të Legjislacionit duke vijuar më tej pranë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, fillimisht në Drejtorinë e së Drejtës Ndërkombëtare dhe Evropiane, sektorin e përafrimit të legjislacionit për të vijuar më pas si përgjegjëse e sektorit të drejtësisë dhe çështjeve të Bbrendshme në Drejtorinë e BE-së.

Znj. Çuçi ka ndjekur studimet e larta të nivelit “Bachelor” në shkencë juridike si dhe të nivelit “Master i shkencave” në “E Drejta civile dhe tregtare” pranë Universitetit “Luarasi”. Gjithashtu, znj Çuçi ka ndjekur studime të nivelit “Bachelor” në shkencë politike, studime ndërkombëtare pranë Universitetit Roma 3, në Romë Itali. Gjithashtu, ajo ka kryer një sërë trajnimesh dhe kualifikimesh në fushën e studimeve politike, integritimit evropian etj.

ANA BURDA

Znj. Ana Burda mban pozicionin e koordinatorit të grupimit të II-të, të kapitujve “Tregu i brendshëm”, në Drejtorinë për Anëtarësimin në BE, në Njësinë e Integrimin Evropian, Departamenti i Politikës dhe Integrimin Evropian në Kryeministri. Më parë, Znj. Burda ka mbajtur pozicionin e këshilltarit pranë ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator, si pjesë e programit “Lead”, ku ka ndjekur çështjet e lidhura me grupimin e parë “Themeloret” dhe grupimin e dytë “Tregun e brendshëm”.

Znj. Burda, më parë ka drejtuar projektin “Mbështetje për procesin e integritit në BE të Shqipërisë” dhe është angazhuar si eksperte financiare për hartimin dhe përmirësimin e dokumenteve ligjore dhe teknike të nevojshme gjatë procesit të integritit evropian në fushën e kontrollit financiar.

Znj. Ana Burda është diplomuar në Financë (MSc). Paralelisht me studimet dhe karrierën e saj, znj. Ana Burda ka qenë atlete dhe skiatore profesioniste dhe së fundi është përzgjedhur anëtare bordi e Federatës së Skive dhe kryetare e Komisionit të Atletëve pranë Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar.

ROBERT ÇEÇO

Z. Robert Çeço mban pozicionin e koordinatorit të grupimit të III-të, të kapitujve “Konkurrueshmëria dhe rritja gjithpërfshirëse”, në Drejtorinë për Anëtarësimin në BE, në Njësinë e Integrimin Evropian, Departamenti i Politikës dhe Integrimin Evropian në Kryeministri.

Ai ka një eksperiencë të gjatë në hartimin dhe monitorimin e politikave të lidhura me zhvillimin ekonomik, social dhe strategjik të vendit, si dhe në zhvillimin e programeve në përputhje me politikën dhe përparësitë e qeverisë.

Z. Çeço vjen me një eksperiencë edhe nga angazhimi me OJQ në fushën e finacave publike mbi vlerësimin e transparencës për çështje që kanë të bëjnë me buxhetin dhe angazhimin e publikut për t’u bërë pjesë e procesit të buxhetit.

Z. Çeço ka kryer studimet e larta në Fakultetin e Ekonomisë në Universitetin e Tiranës si dhe zotëron një diplomë pasuniversitare MBA nga Universiteti i Kardifit në Mbretërinë e Bashkuar.

HADIT KOVAÇI

Z. Hadit Kovaçi aktualisht mban rolin e koordinatorit për grupimin e V-të të kapitujve “Burimet, bujqësia dhe kohezioni” dhe grupimin e VI-të të kapitujve “Marrëdhëniet me jashtë”, në Drejtorinë për Anëtarësimin në BE, në Njësinë e Integrimin Evropian, Departamenti i Politikës dhe Integrimin Evropian në Kryeministri. Në rolin e tij si koordinatör për këto grupkapitujt, ai ofron mbështetje të drejtpërdrejtë për ministrin e Shtetit dhe Kryenegociator në proceset kyçe të integritit evropian të Shqipërisë. Ai është përgjegjës për përgatitjen dhe koordinimin e informacionit me institucionet përkatëse, të kërkuar nga Komisioni Evropian për monitorimin e përparimit të Shqipërisë në përmbushjen e kritereve të anëtarësimit. Nëpërmjet këtij roli, ai siguron që raportimet e

Shqipërisë të jenë të përditësuara, të sakta dhe të pasqyrojnë qartë progresin në sektorët e bujqësisë, sigurisë ushqimore, peshkimit, kohezionit dhe marrëdhënieve me jashtë.

Z. Kovaçi ka përfunduar studimet të nivelit “Master i shkencave” në drejtësi në Universitetin e Tiranës. Ai gjithashtu ka përfunduar programe të ndryshme trajnimi, përfshirë Shkollën Verore ReSPA mbi negociatat e anëtarësimit në kapitujt 23 dhe 24 të BE-së dhe Programin e Trajnimit Enlargement Academy, të organizuar nga Ministria e Jashtme e Polonisë. Gjithashtu, ai ka marrë pjesë në Shkollën Verore 2020, organizuar nga Ministria e Punëve të Jashtme e Kroacisë dhe GIZ, ku trajtoheshin zhvillimet e reja dhe sfidat e integritit në BE.

Në të kaluarën, ai ka mbajtur pozicione të rëndësishme, si përgjegjës i sektorit të mjedisit, bujqësisë, sigurisë ushqimore dhe peshkimit dhe përgjegjës i sektorit të së drejtës evropiane pranë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme. Gjithashtu, z. Kovaçi ka punuar në hartimin dhe monitorimin e zbatimit të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian dhe ka kontribuar në hartimin e kuadrit ligjor institucional për strukturat negociatore në procesin e integritit evropian.

DANIELA TAKO

Znj. Daniela Tako shërben si koordinatore në Departamentin e Politikës dhe Integritit European, në Njësinë e Politikës dhe Agjendës së Reformave drejt BE-së. Ajo vjen prej një përvoje 12-vjeçare në administratë. Më parë, znj. Tako ka shërbyer si koordinatore në sektorin e shoqërisë civile, në sektorin e burimeve kombëtare për zhvillim, ku ka mbuluar sektorët e teknologjisë dhe arsimit dhe në sektorin e planifikimit strategjik ku ka dhënë kontributin e saj për projektet kombëtare prioritare dhe dokumentet strategjike në fushën e transportit, shëndetësisë dhe arsimit.

Gjatë periudhës që ka qenë koordinatore në sektorin e planifikimit strategjik, znj. Tako ka qenë dhe menaxhere e projektit “Zhvillimi i sistemit të planifikimit të integruar të politikave” (IPSIS). Znj. Tako gjithashtu ka shërbyer për 5 vite si përgjegjëse sektori për marrëdhëniet shumëpalëshe pranë Agjencisë Kombëtare për Kërkim, Teknologji dhe Inovacion, ku ka menaxhuar programin Horizont 2020 dhe ka shërbyer si pikë kombëtare kontakti për këtë program. Përpara karrierës së saj në administratë, znj. Tako ka punuar pranë Bankës Kombëtare Tregtare, në Departamentin e Korporatave. Znj. Tako ka kryer studimet në univeristetin e “*Middle East Technical University*” në Ankara, nga ku ka diplomën Për studimet e niveleve “Bachelor” dhe “Master i shkencave” për marrëdhënie ndërkombëtare. Gjatë karrierës së saj, znj. Tako ka kryer një sërë trajnimesh dhe kualifikimesh që lidhen me fushën e projekteve të BE-së, administrimit publik, politikëbërjen bazuar në të dhëna, politikëbërjen në BE, programe të BE-së etj.

AIDA HAMZAJ

Znj. Aida Hamzaj, aktualisht mban pozicionin e koordinatorit në Departamentin e Politikës dhe Integritimit Evropian. Ajo ka një eksperiencë të gjatë në administratën publike, fillimisht në pozicionin e koordinatorit pranë Njesisë për Mbështetjen e Investimeve Strategjike dhe Njesisë së Programeve të Zhvillimit dhe Bashkëpunimit në Kryeministri. Pjesë e karrierës së saj është edhe roli i ekspertit pranë Korporatës Shqiptare të Investimeve. Karriera e saj ka filluar pranë Bashkisë së Tiranës, ku ka pasur pozicionin e përgjegjës të sektorit të aseteve dhe më pas të sektorit të lehtësimit të biznesit.

Përveç angazhimeve të saj në administratën publike, znj. Hamzaj ka pasur eksperiencë ndërkombëtare, duke punuar për UNIMED (Unioni i Universiteteve të Mesdheut) në Romë, Itali. Gjatë periudhës 2018-2022, ajo ka punuar si pedagoge e jashtme pranë Universitetit Metropolitan të Tiranës, si dhe mentore pranë *Metroresearch*.

Znj. Hamzaj ka kryer studimet të nivelit “Master në biznes ndërkombëtar dhe politikat publike” në Itali dhe më pas ka vazhduar studimet për një “Master shkencor në të drejtën civile” në Fakultetin e Drejtësisë në Tiranë. Ajo ka përfunduar gjithashtu studimet e saj të larta në degën e administrimit të biznesit pranë Fakultetit të Ekonomisë, të Universitetit të Tiranës dhe është diplomuar më pas në Fakultetin e Drejtësisë po në Universitetin e Tiranës. Gjithashtu, ajo zotëron licencën në ndërmjetësim nga Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve dhe është kualifikuar si vlerësuese e pasurive të paluajtshme. Znj. Hamzaj ka përfunduar studime pasuniversitare në fushën e “Marketingut të avancuar” dhe ka marrë pjesë në një sërë trajnimesh dhe kualifikimesh ndërkombëtare, përfshirë ato në Itali, Holandë, Japoni, Austri dhe shtete të tjera, ku ka zhvilluar ekspertizë në menaxhimin publik, lidhësi, zhvillimin e qëndrueshëm, planifikimin strategjik, tregtinë ndërkombëtare etj.

REALD KETA

Z. Reald Keta shërben si koordinator në Njësinë Kombëtare për Përafrimin me BE-në, Departamenti i Politikave dhe Integritimit në BE. Ai ka përfunduar studimet të nivelit “Master i shkencave” në Drejtësi, pranë Fakultetit të Drejtësisë, në Universitetin e Tiranës, në vitin 2010. Prej vitit 2012, ka punuar si ekspert ligjor pranë organizatave joqeveritare në çështjet e lidhura me të drejtat e njeriut dhe prej vitit 2017 e në vazhdim ka qenë pjesë e administratës publike.

Z. Keta është një ekspert ligjor dhe kërkues me përvojë me njohuri të diversifikuara mbi aktet ligjore dhe rregullative në çështje të lidhura me pronësinë industriale, proceset zgjedhore, qeverisjen, procesin e integritimit evropian, luftën kundër korrupsionit, reformën në drejtësi, demokratizimin dhe të drejtat e njeriut.

ADA SHANAJ

Znj. Ada Shanaj ka një eksperiencë të gjatë në fushën juridike, duke punuar kryesisht në administratën publike. Aktualisht, znj. Shanaj mban pozicionin e koordinatorit pranë

Njesisë Kombëtare të Përafrimit të Legjislacionit, në Departamentin e Politikës dhe Integritimit Evropian në Kryeministri.

Rrugëtimi i saj profesional ka nisur pranë Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës si dhe pranë Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes në sektorin juridik, duke përfaqësuar institucionin në procese të ndryshme gjyqësore, duke përgatitur akte ligjore dhe ofruar opinione juridike. Gjithashtu, znj. Shanaj ka pasur një eksperiencë të gjatë pranë Ministrisë së Integritimit Evropian dhe Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, ku ka monitoruar dhe koordinuar procesin e certifikimit të përkthimit të *Acquis*.

Znj. Shanaj ka kryer studimet e larta pranë Fakultetit të Drejtësisë “Luarasi” ku ka marrë titullin “Jurist” si dhe ka kryer studimet e larta *part-time* në degën financë-kontabilitet në Fakultetin e Ekonomisë, pranë Universitetit të Tiranës, si dhe ka kryer trajnime dhe kualifikime në fushën e integritimit evropian, gjyqësorit etj.

KORNELIA FERIZAJ

Znj. Kornelia Ferizaj mban pozicionin e koordinatorit në Njësinë e Miëqeverisjes në Departamentin e Politikave dhe Integritimit Evropian prej shkurtit të vitit 2024. Ajo ka një përvojë pune 16-vjeçare në disa institucione vendore dhe qendrore në sektorin publik dhe ka kryer një sërë funksionesh.

Prej vitit 2018-2022 ka drejtuar Agjencinë Kombëtare të Turizmit.

Karriera e saj ka nisur në vitin 2008 pranë Bashkisë Durrës në pozicionin e specialistit në Departamentin e Politikave të Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit, duke vijuar më pas si përgjegjës i sektorit të integritimit evropian në Ministrinë e Mirëqenies Sociale, përgjegjës i sektorit për përgatitjen dhe fizibilitetin e projekteve për marketimin e turizmit në Ministrinë e Turizmit, përgjegjës për bashkërendimin e ndihmës së huaj në Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës, përgjegjës në Drejtorinë e Konvergencës dhe Kohezionit me BE, në Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës, si dhe drejtor i Projekteve dhe Zonave me Prioritet Zhvillimin e Turizmit në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

Znj. Ferizaj ka kryer studimet në Fakultetin e Drejtësisë, të Universitetit të Tiranës. Ajo ka kryer studimet “Master i nivelit të dytë në shkencë administrative” në Tiranë. Gjithashtu, znj. Ferizaj ka kryer një sërë trajnimesh dhe kualifikimesh në fushën e menaxhimit të projekteve, politikave sociale, politikave mjedisore dhe turizmit, si dhe integritimit evropian.

MONIKA MEÇA

Znj. Monika MEÇA, drejtor i Njesisë Ligjore të Vlerësimit dhe Koordinimit të Akteve Prioritare të Këshillit të Ministrave. Znj. Meça ka kryer studimet e larta në Fakultetin e Drejtësisë, të Universitetit të Tiranës, në vitet 1992-1996, dhe ka titullin “Magjistrat” pasi ka ndjekur studimet në Shkollën e Lartë të Magjistraturës në vitet 1997-2000. Znj. Meça është kandidat për gradën shkencore “Doktor i shkencave juridike”, në të drejtën publike, Fakulteti i Drejtësisë, i Universitetit të Tiranës. Prej vitit 2000 dhe aktualisht është ekspert

në Komitetin Evropian të Bashkëpunimit Ligjor, në Këshillin e Evropës, dhe ka qenë anëtar i këshillit mbikëqyrës të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Qendrës së Publikimeve Zyrtare. Znj. Meça ka kryer një sërë trajnimesh dhe kualifikimesh në fushën e së drejtës administrative, të drejtave të njeriut, të drejtës publike, transpozimit e draftimit të legjislacionit, të drejtën e detyrimeve, organizimin e pushtetit gjyqësor, të drejtën penale ndërkombëtare etj në Mbretërinë e Bashkuar, Francë, Danimarkë, Itali, Gjermani, Austri, Poloni, Kroaci, Estoni, Greqi, Holandë, Egjipt etj, dhe ka qenë pjesëmarrës si autor dhe referues në disa konferenca shkencore ndërkombëtare në Sirakuzë, Itali, Vjenë Austri, Bruksel Belgjikë, Bukuresht Rumani si dhe autor i disa artikujve shkencorë në revista ndërkombëtare dhe kombëtare në fushën e jurisprudencës.

Znj. Meça ka një përvojë të gjatë pune, prej vitit 2002, si nëpunës civil në Kryeministri. Në periudhën 2017-2018 ka punuar si drejtor i Përgjithshëm i Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë. Në vitet 1998-2000 ka punuar gjyqtar në gjykatën e shkallës së parë Tiranë. Prej vitit 2006 e në vazhdim, znj. Meça është angazhuar si pedagoge e jashtme në disa universitete private, kryesisht në lëndët e së drejtës administrative, të së drejtës kushtetuese dhe të së drejtës së detyrimeve.

ELIRA ZAKA

Znj. Elira ZAKA mban pozicionin e drejtorit të Njesisë së Programimit të Akteve Rregullatore dhe RIA në Kryeministri. Ajo vjen nga një përvojë e gjatë pune në administratën publike, organizatat ndërkombëtare dhe shoqërinë civile.

Znj. Zaka ka mbajtur postin e drejtorit të Përgjithshëm të Njesisë së Burimeve Kombëtare për Zhvillim, si dhe të Njesisë së Kërkimit dhe Zhvillimit në Kryeministri. Më parë znj. Zaka ka mbajtur postin e drejtorit të Përgjithshëm të Politikave, Strategjive dhe Integritit Evropian në Ministrinë e Brendshme.

Znj. Zaka ka dhënë kontributin e saj si anëtare aktive e shoqërisë civile në demokratizimin e parlamentit shqiptar me studime, analiza dhe publikime, në rolin e drejtorit të Qendrës së Studimeve Parlamentare. Më parë ajo ka punuar në disa organizata ndërkombëtare me seli në Tiranë, si UNDP, *Catholic Relief Services* etj.

Znj. Zaka është diplomuar në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë në vitin 1985. Gjatë karrierës së saj të gjatë të punës ajo ka marrë pjesë si drejtuese, organizatore, folëse dhe kontribuese në shumë konferenca dhe aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare.

INA REXHEPAJ

Znj. Ina Rexhepaj mban pozicionin e koordinatorit në Njësinë e Programimit të Akteve Rregullatore dhe RIA, ku ka shërbyer për një periudhë prej katër vitesh. Ajo vjen nga një eksperiencë e gjerë në fushën e financave dhe ekonomisë, pasi ka shërbyer për një periudhë 5-vjeçare në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, ku ka dhënë kontributin e saj në Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë e Integritit, duke ndihmuar në programimin dhe

përgatitjen e akteve rregullatore, si dhe në fushën e bashkëpunimit ekonomik dhe marrëveshjeve.

Karrierën e saj profesionale znj Rexhepaj e ka nisur pranë një zyrë private konsulence juridike dhe avokatie, ku ka shërbyer për 2 vite dhe ka fituar përvojë të vlefshme në sektorin privat menjëherë pas përfundimit të studimeve.

Znj. Ina Rexhepaj ka përfunduar studimet akademike në nivelin “Bachelor” dhe “Master i shkencave” në të drejtë civile, pranë Fakultetit të Drejtësisë, të Universitetit të Tiranës.

ERIS ÇELA

Z. Eris Çela mban pozicionin e drejtorit të Drejtorisë së Ndikimit Rregullator, në Njësinë e Programimit të Akteve Rregullatore dhe RIA. Z.Çela ka një eksperiencë 10-vjeçare në sektorin publik. Pas diplomimit për drejtësi ka punuar në Ministrinë e Drejtësisë për tri vite (2013-2016), para se të fillonte punë si specialist në Njësinë e Monitorimit të Legjislacionit dhe Programeve, në Kryeministri.

Më tej, gjatë viteve 2018 – 2023 ka mbajtur pozicionin e koordinatorit pranë Njësisë së Programimit të Akteve Rregullatore dhe RIA. Në detyrën aktuale, z. Çela është përgjegjës për drejtimin e procesit të vlerësimit të ndikimit rregullator (RIA), procesit të programimit të akteve rregullatore, si dhe të procesit të konsultimit publik, në përmbushje të detyrimeve kombëtare dhe ndërkombëtare. Njëkohësisht, është përgjegjës për drejtimin e procesit të trajnimit dhe rritjes së kapaciteteve, të anëtarëve të rrjetit RIA në ministritë e linjës, mbi vlerësimin e ndikimit rregullator (RIA).

Z. Çela ka përfunduar studimet universitare pranë Fakultetit të Drejtësisë “*Jean Monnet*”, në Universitetin Paris XI, Francë. Mban diplomën “Master shkencor për të drejtën publike ndërkombëtare dhe evropiane”.

Gjatë viteve 2010-2011 ka përfunduar studimet e nivelit të parë “Master për të drejtën e aktiviteteve ndërkombëtare” dhe më herët (2007-2010) kryer studimet e nivelit “Bachelor për të drejtë publike” në të njëjtin fakultet. Z. Çela zotëron licencën e avokatit, ndërmjetësit, si dhe të ekspertit trajnues për procesin e vlerësimit të ndikimit rregullator. Është njohës shumë i mirë i gjuhës franceze, angleze, italiane dhe spanjolle.

SOFIA KALOSHI

Znj. Sofia Kaloshi është koordinator në Departamentin e Akteve Ligjore Prioritare të Këshillit të Ministrave. Me një eksperiencë disavjeçare në Kryeministri në hartimin dhe monitorimin e politikave kombëtare e sektoriale, monitorimin e proceseve të lidhura me konsultimin publik e ndikimin rregullator, si dhe me monitorimin e zbatimit të programit të qeverisë.

Znj. Kaloshi ka marrë pjesë në disa aktivitete ndërkombëtare dhe shkëmbime eksperiencash lidhur me politikëbërjen e bazuar në të dhëna dhe konsultimin publik.

Znj. Kaloshi ka një eksperiencë të gjatë pune dhe në sektorin privat, në fushën e çështjeve tregtare, ndërkombëtare.

Znj. Kaloshi ka kryer studime të nivelit “Master në shkencë sociale” në Universitetin e Tiranës dhe zotëron gjuhën angleze dhe frënge.

ALEKS ÇAÇI

Z. Aleks Çaçi ka përfunduar studimet në Fakultetin e Drejtësisë, në Universitetin e Gjenevës, Zvicër, ku edhe mbylli ciklin e studimeve me një master të përgjithshëm në drejtësi dhe certifikatën e Shkollës së Avokatisë. Gjatë formimit të tij akademik, ai ka ndjekur eksperiencë akademike në Universitetin e Utrehtit në Holandë dhe në Qendrën e Gjuhëve në Neë York, SHBA. Një pjesë e konsiderueshme e karrierës së tij është zhvilluar në Zvicër, ku ka punuar si këshilltar ligjor në disa studio avokatie. Gjithashtu, ai ka qenë pjesë e një projekti të rëndësishëm shtetëror në Kosovë dhe ka punuar edhe në studio avokatie në Tiranë.

Që nga tetori 2021, ai është i angazhuar në Kryeministri në Shqipëri. Fillimisht, z. Çaçi ka punuar si jurist pranë zyrës së menaxhimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm dhe, që prej marsit 2024, si koordinator pranë Drejtorisë së Cilësisë dhe Monitorimit, në Njësinë e Programimit të Akteve Rregullatore dhe RIA.

Ai flet dhe shkruan në anglisht, frëngjisht, italisht dhe spanjisht.

REZAR VESELI

Z. Rezar Veseli, aktualisht mban pozicionin e juristit në Departamentin e Akteve Rregullatore të Këshillit të Ministrave dhe e ushtron këtë funksion që prej tetorit të vitit 1999. Në periudhën prill 1987 – tetor 1991, z. Veseli ka qenë pedagog i Katedrës Juridike, në Shkollën e Ministrisë së Brendshme (sot Akademia e Policisë). Nga tetori 1991 deri në shator 1999 ka kryer disa detyra, që lidhen me profesionin e juristit, në strukturat e Ministrisë së Rendit Publik, përkatësisht, në pozicionet ndihmës i ministrit, specialist në degën e kërkesë-ankesave, specialist jurist në degën juridike të ministrisë, shef i sektorit juridik në ministri dhe për një periudhë, brenda vitit 2004, ka kryer funksionin e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Rendit Publik.

Z. Rezar Veseli ka kryer studimet e larta në Univeristetin e Tiranës, Fakulteti i Shkencave Politike – Juridike, dega drejtësi, dhe në vitin 1985 është diplomuar dhe ka marrë titullin “Jurist”, duke vazhduar me likuidimin e provimeve pasuniversitare, të formimit të përgjithshëm. Z. Veseli zotëron aftësi të larta profesionale të fituara gjatë ushtrimit të profesionit mësimdhënës në shkollën e lartë, si dhe gjatë kryerjes së detyrave të ndryshme,

në ministri dhe Kryeministri, ku për një kohë të gjatë është përfshirë dhe në shumë raste ka drejtuar procesin e hartimit të akteve ligjore e nënligjore, këshillime dhe oponenca juridike, zgjidhjen e çështjeve juridike, duke kontribuar në unifikimin dhe arritjen e cilësisë juridike të dispozitave të akteve ligjore e nënligjore të miratuara në Këshillin e Ministrave.

Z. Veseli ka marrë pjesë në mjaft seminare e kurse, brenda dhe jasht vendit, në fushën e hartimit të legjislacionit për organizimin dhe funksionimin e administrates publike dhe për çështjet e policimit dhe sigurisë publike.

MADALENA KOJA

Znj. Madalena Koja mban pozicionin e juristit në Departamentin e Akteve Rregullatore të Këshillit të Ministrave. Ajo ka përfunduar studimet në Fakultetin e Drejtësisë, në Universitetin e Tiranës në vitin 2000, me titullin jurist. Në vitin 2003 ka përfunduar studimet “Master për të drejtën evropiane” në Rektoratin e Universitetit të Tiranës dhe prej vitit 2003 mban titullin avokat. Zotëron shumë mirë gjuhët angleze, italiane dhe frënge.

Nga viti 2000 deri në vitin 2012 ka qenë pedagoge me kohë të pjesshme në Fakultetin e Drejtësisë, të Universitetit të Tiranës dhe në disa universitete jopublike.

Ka një përvojë 24-vjeçare në administratën e lartë shtetërore, ku, ndër të tjera, ka punuar në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në Departamentin Rregullator dhe të Përputhshmërisë në Kryeministri dhe në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Znj. Koja ka përvojë të gjatë dhe është e kualifikuar në fushën e hartimit të akteve ligjore e nënligjore, shkrim e arsyetim ligjor dhe oponencë ligjore. Gjithashtu, ka përvojë në ekspertizën ligjore për projekte në fushën e mjedisit të Bankës Botërore, UNDP, GIZ dhe organizatave të tjera ndërkombëtare. Znj. Koja është trajnere e akredituar nga Programi Ndërkombëtar Modular i Zhvillimit Profesional “The Building Resources in Democracy, Governance and Elections” (BRIDGE) dhe ka qenë e ftuar në cilësinë e ekspertit në konferenca, trajnime, *ëorkshop*-e brenda dhe jashtë vendit.

KRISTO BINJAKU

Z. Kristo Binjaku mban pozicionin jurist në Departamentin e Akteve Rregullatore të Këshillit të Ministrave, që prej vitit 2017.

Z. Binjaku më parë ka qenë specialist në sektorin e ligjeve, në Drejtorinë Juridike, në Ministrinë e Mbrojtjes, për periudhën 2003-2008, dhe përgjegjës i sektorit të legjislacionit vendas dhe ndërkombëtar, në Drejtorinë e Legjislacionit, në Ministrinë e Mbrojtjes, për periudhën 2008-2017.

Z. Binjaku ka qenë anëtar në shumë grupe pune për hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore dhe ka dhënë opinion ligjor për zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe për çështje të ndryshme. Gjatë përvojës së tij në Ministrinë e Mbrojtjes z. Binjaku ka përfaqësuar institucionin në disa procese gjyqësore, në të gjitha shkallët e gjykimit. Ka marrë pjesë në komisionet parlamentare gjatë diskutimit të projektligjeve të ndryshme. Procesi i punës lidhet me garantimin e përputhshmërisë me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi të projektakteve që paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, nëpërmjet oponencës juridike, përpara se ato të kalojnë për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Ministrave

Z. Binjaku ka mbaruar Fakultetin e Drejtësisë, në Universitetin e Krajovës, Rumani, si dhe ka kryer shumë trajnime në fushën e hartimit të legjislacionit, administratës publike, integritetit evropian, mbrojtjes dhe sigurisë.

RENATA BALLIU

Znj. Renata Balliu mban pozicionin jurist në Departamentin e Akteve Rregullatore të Këshillit të Ministrave.

Ajo vjen në këtë pozicion pas një përvoje disavjeçare në Drejtorinë e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, në Ministrinë e Brendshme, ku ka dhënë kontribut në procesin e hartimit dhe përafrimit të akteve ligjore e nënligjore që lidhen me fushën e përgjegjesisë shtetërore të Ministrisë së Brendshme, si dhe në përgatitjen e raporteve të vlerësimit të ndikimit për aktet ligjore. Gjithashtu, znj. Balliu ka qenë koordinator për të drejtën e informimit për Ministrinë e Brendshme.

Në vitin 2018 ka marrë pjesë në takimin e nivelit teknik (*Prescreening*), për prezantimin e *acquis* për kapitullin 24, “Drejtësia, liria dhe siguria”, me përfaqësues të Komisionit Evropian, të organizuar në Bruksel, nga Komisioni Evropian.

Znj. Balliu më parë ka qenë e angazhuar dhe ka bashkëpunuar me studio ligjore, në Milano të specializuara në fushën e së drejtës private, civile, të sigurimeve, si dhe mbrojtjen e konsumatorit.

Znj. Balliu ka kryer studimet 5-vjeçare për drejtësi, Departamenti i Jurisprudencës, në Universitetin e Milanos “Bicocca”, si dhe studimet pasuniversitare (2013-2015) në Universitetin e Milano-Statale, specializim 2-vjeçar në profesione ligjore. Njëkohësisht, gjatë kësaj periudhe ka kryer praktikë ligjore pranë Gjykatës për të Miturit, Milano.

Znj. Balliu ka kryer gjithashtu një sërë trajnimesh në fushën e hartimit, përafrimit të legjislacionit, në *Regular Impact Assessment* (RIA), si dhe në fushën e kriminologjisë.

ALMA EMINI

Znj. Alma Emini mban pozicionin jurist në Departamentin e Akteve Rregullatore të Këshillit të Ministrave, që prej muajit shkurt 2020.

Më parë znj. Emini ka punuar për një periudhë disavjeçare në pozicione të ndryshme në Ministrinë e Brendshme, ku ka dhënë kontribut në procesin e përafrimit të legjislacionit

me *acquis* të Bashkimit Evropian, si dhe në hartimin e projektakteve të ndryshme normative, në fushën e përgjegjesisë së kësaj ministrie, duke qenë njëkohësisht anëtare e grupit ndërinstytucional të punës për kapitullin 24, “Drejtesia, liria dhe siguria”. Gjithashtu, ajo ka punuar si juriste në sektorin privat.

Znj. Emini është diplomuar për drejtësi në Fakultetin e Drejtësisë, në Universitetin e Tiranës në vitin 2001 dhe ka kryer studime të nivelit “Master” në “Legjislacioni dhe institucionet evropiane”, në Universitetin e Tiranës.

Znj. Emini ka qenë anëtare e grupit të punës për mekanizmat ligjorë dhe institucionalë për hartimin e Strategjisë së parë Kombëtare të Barazisë Gjinore dhe Dhunën në Familje dhe planit të veprimit, si dhe anëtare në grupe të ndryshme ndërinstytucionale pune për hartimin e projektligjeve që kanë përafuar *acquis* të BE-së.

Znj. Emini ka qenë anëtare e Rrjetit Kombëtar të Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut 2019-2023 dhe anëtare e Komisionit Drejtues të Rrjetit.

Në maj të vitit 2017 ajo ka marrë pjesë në takimin e nivelit teknik (*Prescreening*), për prezantimin e *acquis* për kapitullin 24, “Drejtesia, liria dhe siguria”, me përfaqësues të Komisionit Evropian, të organizuar në Bruksel, nga Komisioni Evropian.

Znj. Emini ka kryer një sërë trajnimesh në fushën e përafrimit dhe hartimit të legjislacionit, në procesin e negociimit në Bashkimin Evropian, integritet në Bashkimin Evropian, shkrimit dhe arsytimit ligjor.

VANGELT DUNI

Z. Vangelt Duni mban pozicionin e juristit në Departamentin e Akteve Rregullatore të Këshillit të Ministrave, pranë Kryeministrit. Z. Duni ka nisur veprimtarinë në administratën publike në vitin 2012, ku është angazhuar si specialistit ligjor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave dhe Ndërtimeve Informale, si dhe më tej si përgjegjës i sektorit të kalimit të pronësisë në të njëjtin institucion.

Me krijimin e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës në vitin 2019 ka ushtruar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të këtij institucioni fillimisht funksionin e përgjegjës të sektorit juridik dhe të hartimit të legjislacionit dhe më pas atë të drejtorit të Drejtorisë së Çështjeve Juridike, pozicion në të cilin ka punuar prej muajit korrik të vitit 2019 deri në muajin dhjetor të vitit 2020. Prej muajit dhjetor të vitit 2020 ka punuar pranë Kryeministrit, fillimisht si koordinator në Njësinë Ligjore të Koordinimit të Nismave Prioritare dhe të *Acquis*, si dhe më pas në Njësinë e Akteve Rregullatore të Këshillit të Ministrave (më tej Departamenti me të njëjtin emërtim).

Z. Vangelt Duni ka kryer studimet e larta në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, ku është diplomuar si jurist në vitin 2010, si dhe në tetor të vitit 2014 është licencuar në fushën e avokatisë. Gjithashtu, në periudhën 2014-2015 z. Duni ka kryer studime të nivelit “Master në fushën e administrimit të biznesit” pranë IFG Tirana – Universtitetit i Bordosë. Është njohës i gjuhëve angleze, italiane dhe franceze.

ADA KALOÇI

Znj. Kaloçi mban pozicionin e koordinatorit në Departamentin e Akteve Rregullatore të Këshillit të Ministrave nga marsi i vitit 2022. Funkzioni i koordinatorit ka si qëllim koordinimin e punës ndërmjet departamenteve të tjera të Kryeministrit, drejtuesit të Departamentit, juristëve të Departamentit dhe Drejtorisë së Dokumentacionit. Mban kontakt të vazhdueshëm me drejtorët juridikë të ministrive të linjës. Znj. Kaloçi asiston në përgatitjen e rendit të ditës së mbledhjeve të drejtorëve juridikë të ministrive, sekretarëve të përgjithshëm të ministrive dhe të Këshillit të Ministrave.

Në periudhën shtator 2021 deri në mars 2022 znj. Kaloçi ka ushtruar funksionin e koordinatorit në Njësinë Ligjore të Koordinimit të Nismave Prioritare dhe të Acquis, në Kryeministri dhe shtator 2020 deri në shkurt 2021 ka qenë në detyrën e koordinatorit në Njësinë e Programimit të Akteve Rregullatore dhe RIA, në Kryeministri. Në periudhën shtator 2015 deri në shtator 2020 ka ushtruar funksionin e specialistit në sektorin e dokumentacionit, në Kryeministri.

Znj. Kaloçi ka përfunduar studimet e nivelit “Bachelor” në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë, në degën “Gjuhë letërsi shqipe”. Në vitin 2014 ka përfunduar studimet e nivelit “Master profesional” në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë, në degën “Redaktori”.

Në vitin 2014 ka përfunduar studimet e nivelit “Master shkencor” në Universitetin Evropian të Tiranës, në degën “Komunikim dhe marrëdhënie me publikun”.

MERITA BUNDO

Znj. Merita Bundo mban pozicionin e koordinatorit në Njësinë e Programimit të Akteve Rregullatorë dhe RIA, Drejtoria e Ndikimit Rregullator, në Kryeministri.

Znj. Bundo vjen nga një përvojë e gjatë pune në administratën publike, e cila përfshin një periudhë 15-vjeçare, kontribut, si koordinatorë në zyrën e menaxhimit të Sekretarit të Përgjithshëm të Kryeministrit, si inspektore në Njësinë e Kontrollit të Brendshëm dhe Antikorrupsionit, si koordinatorë në Njësinë e Miradministrimit, në Kryeministri si dhe në Drejtorinë e Politikave Makroekonomike, në Ministrinë e Financave.

Gjithashtu, ka një eksperiencë disavjeçare në sektorin bankar, në fushën e kredidhënies, menaxhimit të riskut të kredive, të raportimeve, të monitorimeve etj.

Znj. Bumdo ka kryer studimet e larta në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë, si dhe ka kryer studime pasuniversitare në Universitetin e Tiranës dhe atë të Bolonjës.

Znj. Bundo ka ndjekur një sërë kualifikimesh profesionale si dhe ka kryer një sërë trajnimesh jashtë vendit.

IRSIDA KOMICI

Znj. Irsida Komici mban pozicionin e drejtorit të Drejtorisë së Cilësisë dhe Monitorimit pranë Departamentit të Akteve Ligjore Prioritare, në Kryeministri.

Znj. Komici është pjesë e administratës publike që prej vitit 2013 dhe ka shërbyer si nëpunëse civile në funksionet: specialist-jurist, përgjegjës sektori, koordinator pranë zyrës së menaxhimit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe drejtor drejtorie në Departamentin e Akteve Rregullatore në Kryeministri.

Znj. Komici ka kryer studimet e plota 5-vjeçare për drejtësi në Fakultetin e Drejtësisë dhe Administratës, pranë Iniversitetit të Varshavës në Poloni, ku dhe mban titullin “*Master i shkencave në drejtësi*”.

Znj. Komici ka ndjekur një sërë kualifikimesh profesionale mbi lidërsipin në administratën publike, në fushën e sigurisë kombëtare, si dhe ka kryer një sërë trajnimesh jashtë vendit pranë Institutit Evropian të Administratës Publike (EIPA) në Luksemburg, Shkollës Rajonale të Administratës Publike (ReSPA), Institutit të Vjenës (JVI) etj.

Ajo është njohëse e disa gjuhëve të huaja si anglisht, polonisht dhe italisht.

BRISEIDA JAHOLLARI

Znj. Briseida Jahollari shërben si koordinator në Njësinë e Programimit të Akteve Rregullatore dhe RIA në Kryeministri, që prej vitit 2020.

Znj. Jahollari zotëron një diplomë të Integruar të Nivelit të Dytë në Drejtësi (DIND) lëshuar në vitin 2010 nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë.

Znj. Jahollari prej vitit 2011 është pjesë e administratës shtetërore ku ka qenë e emëruar në pozicione të ndryshme, si specialiste, juriste në Drejtorinë Juridike në Departamentin e Administratës Publike, si dhe Këshilltare ligjore, e në vijim si shefe e sektorit juridik në Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, në Ministrinë e Mbrojtjes.

ERISA VASILI

Znj. Erisa Vasili mban pozicionin e koordinatorit pranë Drejtorisë së Ndërveprimit të Brendshëm, në Kryeministri. Znj. Vasili vjen nga një eksperiencë e gjatë në administratën publike, duke filluar si specialiste, vijuar si përgjegjëse sektori, dhe më pas deri në pozicionin koordinator. Aktualisht, ka rreth 9 vite punonjëse në Kryeministri. Ka marrë pjesë në monitorimin e procedurave dhe koordinimin e kuadrit ligjor rregullator, në fushën e sigurisë së komunikimit dhe të informacionit, në funksion të realizimit të objektivave të departamentit.

Znj. Vasili ka qenë pjesë e Departamentit të Inovacionit dhe Mirëqeverisjes, pranë ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, në Kryeministri, ku ka ndjekur hartimin e dokumentacionit dhe ndjekjen e aspekteve procedurale të implementimit, prokurimit dhe raportimit periodik të projekteve të financuara nga Bashkimi Evropian në bazë të marrëveshjes së financimit, të nënshkruar me Komisionin Evropian në fushën e inovacionit dhe fuqizimit të kapaciteteve në fushën e mirëqeverisjes.

Znj. Vasili, më parë ka punuar në Ministrinë e Financave, në Drejtorinë e Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve të asistencës financiare akorduar shtetit shqiptar nga Bashkimi Evropian (Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit - IPA), në sektorin e monitorimit dhe kontrollit të projekteve të financuara nga Bashkimi Evropian.

Gjithashtu, znj. Vasili ka përfunduar studimet në Universitetin e Tiranës, Fakulteti Juridik, dega drejtësi. Znj. Vasili zotëron një diplomë “Master në administrim publik”, diplomë e Nivelit të dytë, pranë Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti i Tiranës. Ajo gjithashtu ka kryer trajnime të ndryshme në fushën e menaxhimit të projekteve.

ERIS MUSARAJ

Znj. Eris Musaraj është koordinatorë pranë Departamentit të Akteve Prioritare. Ajo ka përvojë në koordinimin e procesit të përgatitjes së akteve rregullatore.

Znj. Musaraj është diplomuar në jurisprudencë në Itali dhe ka kryer studime pasuniversitare në procedurë parlamentare dhe hartim legjislativ pranë disa universiteteve në Evropë.

Ajo gëzon titullin “Avokat” prej vitit 2016.

SUZANA NEZAJ

Znj. Suzana Neza mban postin e koordinatorit të zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, duke u kujdesur për bashkëpunimin ndërinstitucional si edhe koordinimin e punës dhe kërkesave të departamenteve në Kryeministri.

Më parë znj. Neza ka shërbyer si asistente, më pas si specialiste pranë të njëjtës zyrë, ku ka siguruar realizimin e proceseve të ndryshme të punës në përmbushje të kërkesave dhe

afateve ligjore që i përkasin fushës së përgjegjësisë së zyrës. Znj. Neza ka një eksperiencë të konsiderueshme mbi 10-vjeçare në sektorin publik dhe atë privat. Znj. Neza ka punuar si specialiste në Avokaturën e Përgjithshme të Shtetit për një periudhë 5-vjeçare.

Znj. Neza i ka kryer studimet e larta në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, dega e gjuhës frënge dhe mban titullin “Mësues i gjuhës frënge për shkollat e mesme”, në periudhën 2003-2007.

Gjithashtu, znj. Neza ka kryer studimet të nivelit “Master” “Qeverisje dhe administrim publik”.

IRENA XHAFI

Znj. Irena Xhafa ka lindur në Tiranë, Shqipëri. Znj. Irena Xhafa është një profesioniste e spikatur me një përvojë të pasur në sektorin privat dhe publik, si dhe në hartimin e politikave. Ajo ka përfunduar studimet në nivelin “Bachelor” dhe “Master i shkencave” në farmaci, në Universitetin e Mjekësisë në Tiranë. Aktualisht, znj. Xhafa shërben si këshilltare në kabinetin e ministrit të Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit.

Znj. Xhafa ka përvojë pune në kompani ndërkombëtare dhe ekspertiza e saj përfshin këshillimin në çështje të marrëdhënieve të jashtme dhe institucioneve financiare si dhe zotëron aftësi të shkëlqyera në nxitjen e partneriteteve midis sektorit publik dhe atij privat.

Deri në shtator 2023, ajo shërbeu si këshilltare e ministrit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, ku lehtësoi komunikimin, koordinimin dhe negociatat me institucione financiare ndërkombëtare, si FMN, Banka Botërore, BERZH, OKB etj., duke kontribuar në stabilitetin dhe rritjen ekonomike të Shqipërisë. Më parë, nga viti 2019, ajo ishte Drejtore e Kabinetit në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, ku drejtoi projekte strategjike dhe reforma, veçanërisht gjatë tërmetit të vitit 2019 dhe pandemisë Covid-19.

Znj. Xhafa është thellësisht e përkushtuar ndaj mbështetjes së zhvillimit ekonomik dhe progresit social të Shqipërisë. Ajo ka marrë pjesë në programe dhe kualifikime nga institucione ndërkombëtare në fushat e saj të ekspertizës.

Znj. Xhafa zotëron shkëlqyeshëm gjuhët anglisht dhe italisht si dhe është e aftë në negociata, planifikim biznesi dhe e specializuar në menaxhimin e projekteve, me një bazë të fortë në detyrat menaxheriale, duke dëshmuar përkushtimin e saj ndaj avancimit të Shqipërisë në një nivel global.

ILIDJONA MALOLLARI (SPAHIU)

Znj. Ilidjona Malollari mban pozicionin e juristes pranë Departamentit të Akteve Ligjore Prioritare të Këshillit të Ministrave që prej datës 15.4.2022. Pas përfundimit të studimeve universitare në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, dega “Drejtësi”, ka vijuar me kryerjen e studimeve “Master i shkencave” në fushën “E drejtë civile”.

Gjatë kryerjes së studimeve universitare ajo ka kryer një sërë trajnimesh e kualifikimesh në fushën e së drejtës pranë institucioneve të drejtësisë në Shqipëri, si Ministria e Drejtësisë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Avokatura e Shtetit, Banka e Shqipërisë etj. Në vijim paralelisht ka mbajtur edhe pozicionin e lektorese brendshme dhe të jashtme pranë Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, dhe Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë duke mbuluar lëndët në fushën e së drejtës publike dhe asaj civile.

Prej vitit 2015 mban titullin “Avokat”, profesion të cilin e ka ushtruar për disa vite në studion ligjore “MALOLLARI”, të themeluar prej saj.

Karriera e znj Malollari ka vijuar duke mbajtur pozicionin e juristit dhe këshilltarit ligjor pranë disa institucioneve publike dhe private dhe së fundi ka shërbyer pranë institucioneve të reja të reformës në drejtësi, pranë Kolegjit të Posacëm të Apelit.

ALBANO KOLLAÇEJ

Z. Albano Kollacej shërben si drejtor në Drejtorinë e Buxhetit dhe Administrimit të Brendshëm, pozicion që e mban që nga shtatori 2023. Në këtë detyrë ai vjen nga një përvojë disavjeçare në Ministrinë e Kulturës si përgjegjës finance, buxheti dhe drejtor Buxheti dhe Menaxhimi Financiar, gjithashtu me një eksperiencë disavjeçare në pozicione të ndryshme në Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) si dhe nga sektori privat.

Z. Kollacej ka mbaruar studimet e larta në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, në Fakultetin Ekonomik, dega financë-kontabilitet (2006-2010) dhe më pas ka kryer një sërë trajnimesh dhe kualifikimesh në fushën e kontabilitetit, është ndërmjetës i certifikuar nga Ministria e Drejtësisë etj, gjithashtu është njohës i shkëlqyer i gjuhës angleze dhe italiane.

ELFRIDA CUKU

Znj. Elfrida Cuku mban pozicionin e këshilltarit të ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator në Kryeministri.

Znj. Cuku ka kryer studimet e larta në Universitetin e Neë York-ut në Tiranë dhe në Universitetin e Neë York-ut në Pragë si dhe ka vijuar studimet e thelluara në fushën e së drejtës së biznesit dhe arbitrazhit në Universitetin e Erasmus, Rotterdam, Hollandë. Prej vitit 2019, është anëtare e Dhomës Kombëtare të Avokatisë. Ajo gjithashtu ka marrë pjesë në trajnime ndërkombëtare ku mund të përmenden “Arbitrazhi ndërkombëtar” pranë Gjykatës së Arbitrazhit në Hagë dhe Arbitrazhi në Hollandë, Amsterdam etj.

Znj. Cuku ka një eksperiencë disavjeçare në sektorin publik që daton në 2018, ku filloi angazhimin e saj në Kryeministri si asistente e Zëvendëssekretares së Përgjithshme të Këshillit të Ministrave. Më tej ka shërbyer si asistente e Kryenegociatorit të Shqipërisë për negociatat e anëtarësimit me Bashkimin Evropian. Në vijim, si këshilltar i Kryenegociatorit të Shqipërisë për negociatat e anëtarësimit me BE-në, duke luajtur një rol të rëndësishëm monitorues dhe gjithëpërfshirës në ndjekjen e disa kapitujve të integritit dhe verifikimit e përputhshmërisë së legjislacionit shqiptar me *acquis communautaire* të BE-së. Znj. Cuku ka qenë përgjegjëse dhe aktive në nënkomitete dhe takime shpjeguese të mbajtura në Bruksel dhe Luksemburg si dhe pjesë e grupit të punës që asistoi në mënyrë permanente në procesin e mbajtjes së Konferencës së Parë Ndërqeveritare.

STELA SULOTI

Znj. Stela Suloti shërben që nga fundi i shtatorit 2024 në kabinetin e ministrit të Shtetit dhe Kryenegociatorit si këshilltare për media dhe marrëdhëniet me jashtë. Më parë, znj. Suloti ka qenë pjesë e grupit të ekspertëve të nivelit të lartë në Komisionin e Posaçëm Parlamentar “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian”.

Gjatë viteve 2022-2024, ajo ka qenë menaxhere e projektit të asistencës teknike të BE-së për mbështetje në implementimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë, dhe në periudhën 2019-2021 ka punuar si këshilltare e ministrit të Drejtësisë për marrëdhëniet me jashtë, integrimin, median dhe politikat antikorrupsion.

Znj. Suloti ka përvojë të gjerë në projekte kërkimore dhe sociale, si dhe planifikim dhe organizim eventesh, përfshirë punën me Qendrën për Studime Ekonomike Sociale në Tiranë, ku ka punuar në projekte dhe studime të ndryshme kërkimore mbi migrimin, si dhe Dhomën Tregtare Gjermano-Shqiptare, ku ka qenë e angazhuar me organizimin e aktiviteteve të rëndësishme si Panairin e parë Virtual të Punës në Shqipëri si dhe projekte mbi arsimin dhe trajnimin profesional.

Gjithashtu, Znj. Suloti ka kontribuar gjerësisht si pjesë e shoqërisë civile pranë EU Policy Hub, Tek Bunkerit, UAË, The Office Tirana si dhe organizatave ndërkombëtare, si GIZ, GOPA dhe FES si eksperte për çështjet e integritit, projekte artistike, strategji komunikimi etj.

Znj. Suloti është diplomuar në Gjermani në shkencë politike, histori arti dhe shkencë mediale si dhe ka ndjekur programe të specializuara për dizajn grafik dhe pikturë. Gjithashtu, ka përfunduar trajnime të avancuara në fushën e politikave dhe çështjeve të integritit. Znj. Suloti zotëron shumë mirë gjuhët angleze, gjermane, italiane, franceze dhe spanjolle.

AMALIA KOKOLI

Znj. Amalia Kokoli mban pozicionin e koordinatorit pranë zyrës së menaxhimit të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, nga muaji shkurt 2024. Më parë ka fituar të drejtën për të qenë pjesë e programit “*Lead Albania 2022-2023*” nga Fondi Shqiptaro-Amerikan i Zhvillimit, nëpërmjet të cilit mbajti pozicionin e këshilltarit pranë institucionit të Kryeministrit, Znj Kokoli ka një eksperiencë 6-vjeçare si këshilltare ligjore në një institucion të rëndësishëm financiar në Shqipëri. Ajo ka përfituar një eksperiencë të mirë në implementimin e së drejtës tregtare për klientët korporatë duke punuar ngushtësisht me bankierë dhe juristë për të lehtësuar veprimtarinë e biznesit të shoqërive tregtare të huaja apo atyre vendase të cilat operojnë në tregun shqiptar.

Znj. Amalia Kokoli ka përfunduar me sukses studimet “Master LLM në të drejtën ndërkombëtare tregtare” pranë *University College London*. Znj. Kokoli gjithashtu është diplomuar në drejtësi dhe zotëron një diplomë “Bachelor” dhe “Master shkencor” në të drejtë civile pranë Universitetit të Tiranës. Në vitin 2023 ka përfunduar programin ekzekutiv “*Emerging Leaders*” pranë *Harvard Business School*. Ndërkohë, në vitin 2015, pasi u kthye nga studimet, ndoqi dhe përfundoi trajnimin pranë Shkollës Kombëtare të Avokatisë ku më pas u pajis me licencën e avokatit nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë. Gjatë studimeve të saj, Znj. Kokoli ka kontribuar dhe është angazhuar si asistente pranë EU Info Centre, një projekt i financuar nga Bashkimi Evropian si dhe ka marrë pjesë në disa trajnime pranë institucioneve ndërkombëtare, si Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Dhoma Kombëtare e Tregtisë, *Center for Creative Leadership* etj.”

ALISA FIERI

Znj. Alisa Fieri mban pozicionin e drejtoreshës së kabinetit pranë ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor që prej shtatorit 2023. Ajo ka përfunduar studimet të nivelit “Master për administrim biznesi”.

Znj. Fieri ka ushtruar një sërë rolesh në Bashkinë e Tiranës, duke përfshirë detyrën si specialiste në task-forcën pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe të Bashkëpronësisë, specialiste në sektorin e strehimit dhe monitorimit në Drejtorinë e Punëve Publike dhe shefe sektori në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të Bashkisë së Tiranës.

SONIL FRASHËRI

Z. Sonil Frashëri shërben si këshilltar pranë kabinetit të ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor që prej janarit të vitit 2024.

Z. Frashëri vjen nga një eksperiencë 12-vjeçare në media në disa televizione të ndryshme si Ora Neës ku ka punuar si reporter dhe kryeredaktor i emisionit politik, *Euroneës Albania* ku shërbeu si redaktor në Departamentin e Informacionit dhe kryeredaktor i disa emisioneve politike, si dhe në televizionin A2 CNN ku shërbeu si redaktor i Departamentit të Informacionit si gazetar.

Z. Frashëri ka përfunduar ciklin “Bachelor” në fushën e marrëdhënieve me publikun dhe komunikimin.

BLERON MENZELXHIU

Që nga shtatori 2023, z. Bleron Menzelxhiu ushtron detyrën e këshilltarit të ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor.

Z. Menzelxhiu ka shërbyer si këshilltar i kryetarit të Bashkisë Tiranë në drejtimin e çështjeve publike dhe zhvillimin e politikave të qytetit nga viti 2020 deri në vitin 2023.

Në vitet 2019-2021 ka dhënë mësim për analizën politike dhe zgjedhjen publike në *Riinvest International*, një qendër e njohur për programe ndërkombëtare nga Universiteti i Londrës dhe Shkolla e Londrës për Ekonomi dhe Shkenca Politike (LSE).

Më herët z. Bleron Menzelxhiu ka qenë udhëheqës i Divizionit për Koordinim të Politikave në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë së Kosovës, duke udhëhequr iniciativat për grupimet industriale dhe zhvillimin e politikave për sektorët e industrisë.

Z. Bleron Menzelxhiu ka përfunduar studime të nivelit “Bachelor” në *Rochester Institute of Technology* Kosova (A.U.K.), me drejtim në menaxhim dhe ekonomi si dhe studimet të nivelit “Master në ekonomi politike të Evropës” në Shkollën e Londrës për Ekonomi dhe Shkenca Politike (LSE).

ALDO MERKOÇI

Z. Aldo Merkoçi shërben si këshilltar pranë kabinetit të ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor. Ai është fokusuar në çështje të tilla si zhvillimi ekonomik i njësisë të vetëqeverisjes vendore (NJVV), demokracia vendore dhe procesi i integritetit të NJVV-ve në Bashkimin Evropian (BE). Z. Merkoçi gjithashtu shërben si anëtar i Këshillit Bashkiak të qytetit të Tiranës.

Më parë, z. Merkoçi ka dhënë kontributin e tij në sektorin e shoqërisë civile duke u angazhuar në organizata lokale dhe ndërkombëtare, me një fokus në demokratizimin e Ballkanit Perëndimor, luftën kundër racizmit në Evropë, transparencën e institucioneve publike, digjitalizimin e shërbimeve dhe financimin e fushatave elektorale.

Në vitin 2024, z. Merkoçi ka përfunduar programin e edukimit ekzekutiv nga Universiteti i Harvardit, “*Leading Green Growth: Economic Strategies for a Low-Carbon World*”. Ndërkohë, ai ka mbaruar studimet në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin Ekonomik.

SAIMIR ALIJA

Z. Saimir Alija, me profesion gazetar, shërben si këshilltar i ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin.

Z. Alija ka shërbyer për një periudhë 10-vjeçare si specialist/gazetar pranë Zyrës së Shtypit në Ministrinë e Mbrojtjes. Z. Alija gjithashtu për një periudhë 1-vjeçare ka shërbyer pranë

Ministrisë së Brendshme në pozicionin e këshilltarit për mediat të ministrit në kabinetin e ministrit të Brendshëm.

Z. Alija ka marrë pjesë në disa projekte dhe aktivitete të ndryshme brenda dhe jashtë vendit sa i përket fushës së komunikimit dhe marrëdhënieve me publikun.

Z. Alija është diplomuar për gazetari, në Fakultetin e Shkencave Humane, në universitetin “Aleksandër Xhuvani” në Elbasan në vitet 2006-2009, ndërsa ka kryer studime të nivelit “Masteri i shkencave” në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes në Akademinë e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.